

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1

5 86

Apostol Duka

**VRAPI
I STINËVE**

poezi

81H-1
D 86




Apostol Duka

RAMAZAN VONCA

VRAPI I STINËVE

poezi



12157

421

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



*Cili s'përi roje dimër edhe verë
fliadet e secretet ka
cili nuk e ndjeu gjoksin më të gjërë
mbi gjoksin e madh e pjehor të tokës?*

MEDITIM NGA VENDROJA

Ëndrrat, emocionet ecin në vendrojë
porsi zogi të bardhë, të dashur, të butë,
më ulen mbi supe e më ledhatojnë,
nëpër krahë muzgjesh nata rend mbi fushë.

Qëndroj në vendrojë i gatshëm, i qetë,
toka-nënë gjoksin ul e ngre pareshtur;
o moj tok' e dashur, ç'fjalë po më flet
gjoksi yt i valë, me thesare veshur?

Nata pranverore flet me ligjërime,
gjithë dashuritë ulen pranë meje,
gjithë dashuritë derdhin vezullime
përmbi armën time, në zemër, në deje.

Po cilit, kur ndenji gati në vendrojë,
ditën apo natën, duke vigjëlur,
nuk iu duk se toka i foli me gojë,
kush nga këto çaste nuk u mrekullua?!...

Cili s'bëri roje dimër edhe verë,
flladet e acaret kujt s'ia krehën flokët,
cili nuk e ndjeu gjokin më të gjerë
mbi gjoksin e madh e pjellor të tokës?...

...
...
...
...
...

...
...
...
...
...

...
...
...
...
...

...
...
...
...
...

NJË URIM NË MALE

Kur edhe ti në këtë jetë,
yt atë ishte nëpër male,
midis ushtarëve të thjeshtë
jepte komanda e sinjale.

Kur, mes sinjaleve të sertë,
erdhi një frazë e gëzuar,
thonë se edhe malin e blertë
yt atë e ka përqafuar.

Dhe thirri, gjithë në një gojë,
toga e hapur në variant:
«Gëzuar edhe të na rrojë
ky djali yt, o komandant!...»

Dhe ecte jeta tërë vrulle,
si lumë në rrjedhën e saj,
kudo po çelën lule
dhe trëndafila, ishte maj...

VOGËLUSHJA TEFTA

Vogëlushja Tefta, me sytë ngjyrë ulli,
që e ka zërin si cicërima e dallëndyshes,
sheh yllin tim, e prek me dashuri
dhe kokën vë në prehërin e gjyshës.

Ç'më thua, vogëlushe, me syt' e tu të zes,
ç'më flet me zërin tënd si cicërimë,
një det me ngazëllime në syt' e tu ç'u ndez
dhe në buzë kaq lule ç'të mbinë?...

Ti do të rritesh, se vitet kalojnë,
do të takohemi sërish të dy,
pastaj, të përmalluar, do kujtojmë
lulet që na buluan nëpër sy.

Dhe kështu, të dashur, të pafajshme,
të takofsha, vogëlushja Teftë,
si një urim të bukur për të ardhmën,
të bëri xhaxhi oficeri këtë vjershë:

VRAPI I STINEVE

Fshatirim, i ngritur
thellënjëlugine,
e pret i djersitur
ardhjen e çdo stine.

Çdo stinë, çdo maaj
ka këngën e vetë,
asnjë si e huaj
tek në nuk tróket.

Já, erdhi pranvera,
çapkënia e blertë,
fushave të gjera
bari përkëdhelet.

Zhurmojnë burimet
në lugjë e pyje,
çiftet, në takime,
numërojnë yjë.

Pemët çelin lule,
zemrat dashuri,

nëpër vargje ulet
një motiv i ri...

Seç na erdhi vera,
pemët u ngarkuan,
dhe balukeprerat
na u zbukuruan.

Kuqëlora te pema
molla e qershia,
qeshet në pelena
si pëllumb fëmija.

Si bark i argjendte
drapëri në ara,
ku buçet një këngë
për korrijet e mbara.

Makina e shirjes
përpin duaj gruri
dhe këngët e thirrjet
gëzojnë dhe gurin...

Vera fluturoi
e na erdhi vjeshta,
zverdh në degë ftoi,
rrushin e pjek vreshta.

Sjell aq shumë ngjyra
kjo vjeshta, piktore
dhe qeshet natyra
si nënë pjellore.

Sjell ditë me diell,
bollëk në prodhimet,
por zogjtë në qiell
nisin shtegëtimet.

Dhe kjo do të thotë;
iku vjesht' e dytë,
vjen dimri i ftohtë,
bora të lbyr sytë.

Dimri shfryn bulçitë
viseve të gjera,
varen nga çatitë
akujt, si gjilpëra.

Le të fryjë erë,
fshati është' i qetë,
në vjesht' e në verë
vuri zahiretë.

Dhe pse ka jehona
e rrufe në qiell,

katër stinët tona
në i kemi diell.

Vlon puna mes erës,
me këngë, shakara,
fëmija i verës
flet fjalët e para.

Cicërim e mitur —
si zë laureshe,
mötivi i rritur
se ç'na u bë vjershë...

Mbledhja e këmbës
është e vjetër
është e vjetër
është e vjetër

Është e vjetër
është e vjetër
është e vjetër
është e vjetër

Është e vjetër
është e vjetër
është e vjetër
është e vjetër